REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kërkesës së Drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan të datës 28.08.2026, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM
PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Me këtë Vendim,**TRANSFEROHET,** shuma e mjeteve në vlerë prej 220,00 € (dyqind e njëzet euro), për pagesën ndërkombëtare të anëtarësisë në rrjetin e spitaleve ndërkombëtare HPH (Health Promoting Hospitals), sipas kërkesës së Drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan të datës 28.08.2026 duke u bazuar edhe në cerifikatën HPH Certificate 2025 to 2028 e datës 19.06.2025 me Nr. 383-003 dhe Faturës – INVOICE No.5353-037-10093 for membership fee 2026.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026, kategoria ekonomike – mallra dhe shërbime të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – QKMF në xhirollogarinë bankare nr. DE90 2007 0024 0338 5242 04 në Bankën me emërtimin DB Privat –und Firmenkundenbank .

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 400/01-44587
Lipjan, më 01.09.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27 e datës 03 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT MBI PËRCAKTIMIN E POZICIONEVE PËR FURNIZIM ME KARTELA MBUSHËSE PËR TELEFONA MOBIL PËR VITIN 2026 1Nr.030/01-2572 I DATËS 19.01.2026

I. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet pika I e Vendimit mbi përcaktimin e pozicioneve për furnizim me kartela mbushëse për telefonat mobil për vitin 2026, 1Nr.030-01-2572 i datës 19.01.2026 si vijon:

Pika e I, te pjesa tabelare, numri rendor 7, pozicioni i punës Inspektor i Ndërtimtarisë (Drejtorati për Inspeksion) nga numri i kryersve 1 shtohet edhe 1 kyers përkatësisht 2 kryersë gjithsej ashtu që numri rendor 7 merr këtë përmbajtje:

Nr	Funksioni	Nr i Kryersve	Shuma mujore
7.	Inspektor i ndërtimtarisë	2	10 €

II.Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin të njoftohet, Drejtorati për Inspeksion dhe Menaxheri i Kontratës Behar Aliu.

1Nr.030/01-2572/4
Lipjan, më 30.09.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit së Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Listës pritëse të spërkatëseve e publikuar nga Komisioni me Nr.12-320/01-20080 e datës 30.04.2026 duke u bazuar edhe në Rekomandimin e Drejtorit të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari të datës 29.09.2026, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM
PËR NDARJEN E SPËRKATËSEVE PËR FERMERË TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Me këtë Vendim, NDAHEN 16 (gjashtëmbëdhjetë) spërkatëse me qëllim të subvencionimit të fermerëve të Komunës së Lipjanit të cilët kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.12-320/01-014946 të datës 04.04.2025 dhe të cilët janë renditur në tabelën vijuese:

1	Behar	Shaban	Ajnuni	Dobrajë e Madhe
2	Afrim	Islam	Bllaca	Ribar I Madh
3	Ajvaz		Ukshini	Gadime e Epërme
4	Arben	Mustaf	Avdiu	Llugaxhi
5	Bujar	Vesel	Kozhani	Ribar I Madh
6	Driton	Muharrem	Hoxha	Topliqan
7	Egzon	Gafurr	Bytyqi	Qylage
8	Gafurr	Ahmet	Gashi	Janjevë
9	Habib	ISuf	Bahtiri	Dobrajë e Madhe
10	Imri	Munish	Luma	Kraishtë
11	Isuf	Mustaf	Hoti	Ribar I Madh

12	Isuf	Bajram	Hoxha	Topliqan
13	Mehmet	Daut	Tmava	Llugaxhi
14	Qendresa	Mustafe	Bulliqi - Bytyqi	Sllovi
15	Ramadan	Behxhet	Isufi	Gumnasellë
16	Sadri	Behlul	Syla	Janjevë

Neni 2

Të drejtat dhe obligimet në mes të Komunës dhe përfituesve të spërkatëseve do të përcaktohen më detajisht në Marrëveshjet të cilat do të lidhen në mes Kryetarit të Komunës dhe secilit fermer veq e veq.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtorati për Prokurim dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti do të publikohet në Webfaqen Zyrtare të Komunës.

1Nr. 320/01-49960
Lipjan, më 30.09.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e listës përfundimtare për OJQ-të për Thirrje publike me Nr.05-453/01-34248 i datës|:23.07.2026 "Për ofrimin e mbështetjeve financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve lidhur me organizimin e aktiviteteve sportive "Sporti-Mundësi për të gjithë në Komunën e Lipjanit" në Komunën e Lipjanit, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ -të

Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **30,960.00 €** (tridhjetëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë euro), për t`i mbështetur financiarisht **OJQ**-të të cilat kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-34248 të datës 23.07.2026 "Për ofrimin e mbështetjeve financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve lidhur me organizimin e aktiviteteve sportive "Sporti-Mundësi për të gjithë në Komunën e Lipjanit".

2. Në tabelën vijuese janë OJQ-të të cila do të mbështetet finanaciarisht nga Komuna.

Nr.	Emërtimi i OJQ-ve	Shuma
1.	Klubi i PingPongut "Ulpiana"	**1,500.00 €**
2.	Klubi i Volejbollit " Ulpiana" femrat	**7,000.00 €**
3.	Klubi i Futbollit "Arbëria"	**9,460.00€**
4.	Klubi i Volejbollit "Ulpiana" meshkuj	**7,000.00€**
5.	Klubi i Hendbollit "Ulpiana" meshkuj	**3,000.00€**
6.	Klubi i Hendbollit "Ulpiana" femra	**3,000.00€**
7.	**Shuma Totale**	**30,960.00€**

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2026 të Drejtoratit për Kulturë ,Rini dhe Sport.

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-ve do të rregullohen në kontratë e cila do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe OJQ-ve përfituese.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë,Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 453/01-46810
Lipjan, më 08.09.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **10,080.00€,** (dhjetëmijë e tetëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-45789 e datës 02.09.2026, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 36 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin gusht të vitit 2026 me nga 280 euro për secilin rast 36 x 280 =10,080.00€, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-45789
Lipjan, më 03.09.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit së Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Listës pritëse të frezave e publikuar nga Komisioni me Nr.12-320/01-20078 e datës 30.04.2026 duke u bazuar edhe në Rekomandimin e Drejtorit të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari të datës 29.09.2026, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM
PËR NDARJEN E FREZAVE PËR FERMERË TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Me këtë Vendim, NDAHEN 27 (njëzet e shtatë) freza me qëllim të subvencionimit të fermerëve të Komunës së Lipjanit të cilët kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.12-320/01-014946 të datës 04.04.2025 dhe të cilët janë renditur në tabelën vijuese:

1	Abedin		Maholli	Gadime e Ulët
2	Agron	Hafir	Olluri	Hallaq I Madhë
3	Alkion	Gafurr	Recica	Llugaxhi
4	Avdush	Hasan	Thaqi	Smallushë
5	Dardan	Shaqir	Kadriu	Hallaq I Vogël
6	Elmi	Ramë	Karpuzi	Shalë
7	Faton	Xhavit	Gashi	Akllap
8	Fazli	Shyqeri	Hyseni	Gadime e Epërme
9	Habib	Halit	Dedushi	Kraishtë
10	Hasim	Nuhi	Shala	Kraishtë
11	Hazbi	Behxhet	Dedushi	Kraishtë
12	Hazir	Ferat	Shabani	Gadime e Epërme

13	Jetmir	Feim	Krasniqi	Lipjan
14	Labinot	Avdush	Mollopolci	Grackë e Vogël
15	Mehdi	Sylë	Morina	Kraishtë
16	Mentor	Fadil	Demiri	Banullë
17	Mirsad	Vehbi	Buja	Bujan
18	Nexhat	Haki	Marevci	Marevc
19	Nuhi	Ramadan	Magashi	Llugaxhi
20	Nuhi	Vehbi	Gallapeni	Magure
21	Qazim	Ejup	Aliu	Kojskë
22	Rame	Jahir	Bardhi	Magure
23	Shaban	Ferat	Gerbeshi	Sllovi
24	Shaip	Haxhi	Olluri	Krojmir
25	Shkurte	Qerim	Bajraktari	Baicë
26	Valdrin	Milaim	Banushi	Poturovc
27	Zeqir	Shaip	Marevci	Marevc

Neni 2

Të drejtat dhe obligimet në mes të Komunës dhe përfituesve të frezve do të përcaktohen më detajisht në Marrëveshjet të cilat do të lidhen në mes Kryetarit të Komunës dhe secilit fermer veq e veq.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtorati për Prokurim dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti do të publikohet në Webfaqen Zyrtare të Komunës.

1Nr. 320/01-49961
Lipjan, më 30.09.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 34 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, nenit 24 të Ligjit të Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar dhe të konsoliduar, Rregullores 15Nr. 352-47361 për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit e datës 30.09.2020, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, duke u bazuar në Raportin për gjendjen e grumbullimit, transportimit dhe menaxhimit të mbeturinave komunale në territorin e Komunës së Lipjanit Nr.01-352/01-46581 të datës 07.09.2026, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

VENDIM
PËR INICIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR KONTRAKTIMIN E SHËRBIMEVE TË GRUMBULLIMIT DHE TRANSPORTIMIT TË MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

I.OBLIGOHET, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim që të bëjë përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe inicojë procedurën pranë Drejtoratit për Prokurim për kontraktimin e shërbimeve të grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

II. Drejtorati për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim në bashkëpunim me njësitë tjera kompetente është i obliguar të përgatitë specifikimet teknike, Termat e Referencës, paramasën dhe parallogarinë, duke përcaktuar territorin e mbulimit, frekuencën, itineraret, standardet e shërbimit, kapacitetet minimale të operatorit dhe mënyrën e matjes e verifikimit të shërbimit .

III.OBLIGOHET Drejtorati për Prokurim që pas pranimit të dokumentacionit të nevojshëm nga njësitë kompetente, të ndërmarrë veprimet për inicimin dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit.

IV. Gjatë përgatitjes së dokumentacionit të tenderit duhet të sigurohet që shërbimi të jetë i matshëm, i verifikueshëm dhe i kontrollueshëm, ndërsa pagesa të bëhet në përputhje me shërbimin e realizuar dhe njësitë e përcaktuara në paramasë dhe në kontratë.

V. Të gjitha kërkesat, kriteret, specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës duhet të jenë në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës, trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe përdorimit efikas të mjeteve publike, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

VI. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtorati për Prokurim.

VII. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Komuna e Lipjanit në kuadër të përgjegjësive të saj ligjore për organizimin dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve publike, menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik ka shqyrtuar gjendjen aktuale të grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit.
Nga Raporti për gjendjen e grumbullimit, transportimit dhe menaxhimit të mbeturinave komunale në territorin e Komunës së Lipjanit Nr.01-352/01-46581 të datës 07.09.2026, rezulton se në periudhën e fundit janë evidentuar probleme serioze në realizimin e rregullt dhe të qëndrueshëm të këtij shërbimi. Në zona të caktuara të Komunës veçanarisht në zonat rurale janë raportuar vonesa në grumbullimin e mbeturinave prej 2 deri në 3 javë të cilat kanë rezultuar me tejmbushjen e kontenjerëve, grumbullimin e mbeturinave jashtë tyre dhe krijimin apo zgjerimin e pikave të ndotura ilegale.

Nga të dhënat e paraqitura në raport rezulton gjithashtu se KRM "Pastrimi" po përballet me:

1. vështirësi financiare
2. kapacitetet aktuale teknike dhe operative të KRM "Pastrimi" nuk janë të mjaftueshme për të siguruar shërbim të rregullt në tërë territorin e Komunës
3. numër të pamjaftueshëm të automjeteve ,
4. numër të pamjaftueshme të kontenjerëve .

Me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina dhe Ligjit të Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, përcaktohet e drejta e Komunës që të bëjë menaxhimin e mbeturinave komunale përmes kontratave të veçanta me një apo më shumë operator publik ose privat për menaxhimin e mbeturinave dhe gjithashtu përcaktohet që komuna me Ligjin përkatës për Prokurim mund të përcaktojë të gjitha kushtet e nevojshme për zgjedhjen e operatorit për ofrimin e shërbimeve publike për menaxhimin e mbeturinave komunale.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:
Drejtoratit për Shërbime Publike
Drejtoratit për Prokurim

1Nr. 352/01-46888
Lipjan, më 08.09.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF -NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve –, që kanë aplikuar sipas thirrjes publike " Sporti për Kategorin e Seniorëve për vitin 2026" Nr.05-453/01-43556 të datës 25.08.2026, në përbërje si vijon:

1. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Arta Krasniqi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Bahri Limolli në cilësinë e ekspertes të jashtëme, anëtare
5. Vjosa Gashi , nga OJQ, anëtare
6. Pranvera Krasniqi , Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare rezervë

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kanë aplikuar sipas thirrjes publike „Sporti për Kategorin e Seniorëve për vitin 2026" Nr.05-453/01-43556 të datës 25.08.2026 ,të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. Komisioni do t'i kryejë detyrat konform dispozitave të Rregullores MF -NR -04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr 020/04-48728
Lipjan, më 21.09.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr :

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

I. Me këtë vendim, formohet Komisioni për trajtimin e statusit të 5 (pesë lokaleve) të ndërtuara paraprakisht në pronë komunale, në këtë përbërje:

1. Imri Semertishti, Drejtor i DPUMM, Kryesues
2. Gafurr Hetemi,Udhëheqës i Sektorit pronësor juridik, anëtar
3. Vlora Krasniqi, Udhëheqëse e Sektorit për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare
4. Ilir Shala, Udhëheqës i Sektorit për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar
5. Jalldyze Gashi Kallaba, DPUMM, anëtare

II. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit është trajtimi i 5 (pesë) lokaleve të ndërtuara, paraprakisht në pronën komunale në parcelën kadastrale 1920/2 ZK- Lipjan, 4 (katër) prej të cilave ndodhen në rrugën "Lidhja e Prizrenit" të dhëna në shfrytëzim përmes Vendimit të Kuvendit Komunal, tanimë me afat të skaduar të kontratës dhe 1 (një) lokal cili gjendet në rrugën "Tahir Sinani" i dhënë në shfrytëzim, përmes Vendimit të Kuvendit të Komunal me validitet të kontratës deri në vitin 2028.

Trajtimi i këtyre lokaleve përfshin:

1.Identifikimin e statusit të lokaleve;
2.Matjen e sipërfaqeve sipas gjendjes faktike në teren;
3. Shqyrtimin e projektit të ndërtimit dhe lejes ndërtimore
4. Shqyrtimin e dokumentacionit lidhur me mundësinë e posedimit të pranimit teknik dhe certifikatën e përdorimit, si dhe
5. Veprime tjera procedurave konform dispozitave të legjislacionit në fuqi për regjistrimin e të njëjtave në regjistrin kadastral si njësi lokale në pronësi të komunës

III. Lidhur me detyrat e lartëcekura, Komsioni ka për detyrë që të hartojë raport me sjhkrim për Kryetarin e Komunës më së largu në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, Raportit duhet t`i bashkëngjitet edhe skica e lokaleve.

IV.Me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

V. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

1Nr. 020/04-49233
Lipjan, më 24.09.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VERIFIKIMIN, ARKIVIMIN DHE ASGJËSIMIN E LËNDËVE NË ARKIVIN KOMUNAL

Neni 1
Përbërja e Komisionit

Me këtë Vendim formohet Komisioni për verifikimin, arkivimin dhe asgjësimin e lëndëve në arkivin komunal, në përbërje si vijon:

1. Burim Gashi, Kryesues
2. Burbuqe Ahmeti Morina, anëtare
3. Ramadan Nuredini, anëtar

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Detyrë e Komisionit është që në pajtim të dispozitave ligjore në fuqi të bëj vlerësimin, arkivimin dhe asgjësimin e lëndëve të cilat kanë mbetur të pa përfunduara nga Komisioni paraprak dhe të njëjtat të sistemohen në zyrat e arkivit dhe të Drejtorive përkatëse .

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë me kopjen e të cilit do të njoftohen Drejtoresha e Drejtoratit për Administratë, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e Komsionit për verifikimin, arkivimin dhe asgjësimin e lëndëve në arkivin komunal 1Nr.020/04-22189/2 i datës 15.05.2026.

1Nr.020/04-22189/2
Lipjan, më 18.09.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr.03/L-2012 të Punës, nenit 25 të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR.01/2024 për rregullimin e procoedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës nxjerr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të stafit arsimor për procesin e konkursit publik të shpallur nga Drejtorati i Arsimit- për Disa SHFMU– Lipjan Nr.01.111/01-34587 i datës 24.07.2026, në këtë përbërje:

1. Mexhide Gashi, DKA, Kryesuese,
2. Behar Aliu, Zyrtar Ligjor, anëtar dhe
3. Medina Bublica, Sektori për personel, anëtare

Neni 2
Detyrat e punës

1. Detyrë e Komisionit të ankesave është shqyrtimi i ankesave për procesin e konkursit publik të shpallur nga Drejtorati për Arsim– për Disa SHFMU– Lipjan Nr.01.111/01-34587 i datës 24.07.2026 si dhe ka mandat të përkohshëm përkatësisht vlen vetëm për procedurat e konkurseve të cekur.
2.Komisioni shqyrton ankesën dhe publikon rerezultatin përfundimtar brenda 5 (pesë) ditëve dhe për secilën ankesë nxjerr vendim në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ MFPT-NR.01/2024 për rregullimin e procoedurave të konkursit në sektorin publik si dhe Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Neni 3
Hyrja në fuqi

1. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Arsim, Kryesuesja dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-49073
Lipjan, më 23.09.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr.03/L-2012 të Punës, nenit 25 të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR.01/2024 për rregullimin e procoedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës nxjerr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të stafit arsimor për procesin e konkursit publik të shpallur nga Drejtorati i Arsimit- për ÇEAP Çerdhja PNF Rufci i Ri– Lipjan Nr.01.111/01-34592 i datës 24.07.2026, në këtë përbërje:

1. Shqiprim Qeriqi, DKA, Kryesues,
2. Liridon Duhlaku, DKA, anëtar dhe
3. Medina Bublica, Sektori për personel, anëtare

Neni 2
Detyrat e punës

1. Detyrë e Komisionit të ankesave është shqyrtimi i ankesave për procesin e konkursit publik të shpallur nga Drejtorati për Arsim– për ÇEAP Çerdhja PNF Rufci i Ri – Lipjan Nr.01.111/01-34592 i datës 24.07.2026 si dhe ka mandat të përkohshëm përkatësisht vlen vetëm për procedurat e konkurseve të cekur.
2.Komisioni shqyrton ankesën dhe publikon rerezultatin përfundimtar brenda 5 (pesë) ditëve dhe për secilën ankesë nxjerr vendim në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ MFPT-NR.01/2024 për rregullimin e procoedurave të konkursit në sektorin publik si dhe Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Neni 3
Hyrja në fuqi

1. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Arsim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-49076
Lipjan, më 23.09.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 19 të Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR INVENTARIZIMIN E PASURISË JOFINANCIARE TË KOMUNËS

I. Për inventarizimin e pasurive jofinanciare të Komunës formoj Komisionin në këtë përbërje:

1. Burim Gashi, Drejtorati për Administratë, Kryesues
2. Islam Kaleshi, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtar
3. Ramiz Gashi, DKRS, anëtar
4. Shehide Sopa Ibrahimi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
5. Alban Bytyqi, QKMF, anëtar

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni në pajtim me Rregulloren nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore, ka për detyrë dhe përgjegjësi si vijon :

1. Të inventarizoj të gjithë pasurinë jofinanciare që është në pronësi dhe kontroll të Komunës,
2. Të bëj verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes të pasurisë jofinanciare ,
3. Të bëj krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jofinanciare,
4. Të identifikojë pasurinë që nuk ka vlerë të bartur,
5. Të identifikojë pasuritë e dëmtuara dhe jashtë përdorimit

III. Përgatitja e raportit për kryerjen e inventarizimit

Komisioni pas kryerjes së inventarizimit duhet të hartoj dhe prezentoj raportin për inventarizimin e pasurisë jofinanciare më së largu deri me datë 15 Janar 2027.

IV. Me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

V. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

1Nr. 020/04-49078
Lipjan, më 23.09.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 , Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATËS

Neni 1

Me këtë Vendim, **Ramiz Gashi**, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës të OJQ-së përfituese të subvencioneve sipsas Thirrjes Publike për mbështetje Financiare për Aktivitete të Organizatave Joqeveritare në fushen e Sportit " sipas thirrjes me Nr.05-453/01-34248 e datës: 23.07.2026 , të shpallur nga Drejtorati për Kulturë,Rini dhe Sport.

2. Në tabelën vijuese janë OJQ-të të cila duhet të monitorohen nga zyrtari përgjegjës i cekur më lartë .

Nr.	Emërtimi i OJQ-ve
1.	Klubi i PingPongut "Ulpiana"
2.	Klubi i Volejbollit " Ulpiana" femrat
3.	Klubi i Futbollit "Arbëria"
4.	Klubi i Volejbollit "Ulpiana" meshkuj
5.	Klubi i Hendbollit "Ulpiana" meshkuj
6.	Klubi i Hendbollit "Ulpiana" femra

Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontratave të OJQ-ve përfituese të subvencioneve , konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës Ramiz Gashi dhe Drejtorati për Kultur,Rini dhe Sport.

1Nr. 112/02-49072
Lipjan, më 23.09.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti